

Statuti i Universitetit të Evropës Juglindore

Pjesa I: Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

1. Universiteti i Evropës Juglindore është institucion i arsimit të lartë privat-publik jofitimprurës, i cili përbëhet nga fakultetet, qendrat dhe institutet si pjesë integrale të tij.
2. Emri i Universitetit në gjuhën angleze është ‘South East European University’, që mund të përdoret edhe në formën e shkurtuar si ‘SEE University’.
3. Emri i Universitetit në gjuhën shqipe është ‘Universiteti i Evropës Juglindore’, ose shkurt, ‘Universiteti i EJL’.
4. Emri i Universitetit në gjuhën maqedonase është **‘Универзитет на Југоисточна Европа’**, ose shkurt, ‘ЈИЕ универзитет’.
5. Emri ceremonial i Universitetit në gjuhën latine është ‘Universitas Europae Orientalis Meridionalis.’
6. Selia e Universitetit është në rrugën ‘Ilindenska’ p.n., 1200 Tetovë, Republika e Maqedonisë, Ilindenska b.b., 1200 Tetovo Republic of Macedonia, Илинденска бб, 1200 Тетово, Република Македонија.

Neni 2

Universiteti i EJL (‘Universiteti’) do të:

- i. ndjekë rrugën e përsosjes në mësimdhënie dhe hulumtim;
- ii. jetë i hapur për të gjithë, në baza të paanësisë dhe meritës, pavarësisht përkatësisë etnike;
- iii. bashkëpunojë në mënyrë aktive me universitetet tjera në Republikën e Maqedonisë por edhe në Evropën Juglindore në tërësi

dhe si qëllim kryesor do të ketë:

- i. të kontribuojë për arsimin e lartë në gjuhën shqipe;

- ii. të promovojë mirëkuptimin ndëretnik;
- iii. të sigurojë një qasje shumëgjuhëshe dhe shumëkulturëshe ndaj mësimdhënies dhe hulumtimit; dhe
- iv. të zhvillojë programet e mësimdhënies në një perspektivë të gjërë evropiane dhe ndërkombëtare.

Neni 3

1. Universiteti gëzon autonomi institucionale në kuadër të ligjit jashtë çdo lloji ndikimi politik ose ndikimi tjetër të jashtëm sa u takon aktiviteteve të tij.
2. Personeli dhe studentët e Universitetit gëzojnë:
 - i. liri të partneritetit dhe shprehjes brenda strukturave të përmendura në këtë Statut dhe politikave të shpallura nga Universiteti;
 - ii. të drejtën e mos-diskriminimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mbi baza ekzistuese ose të supozuara si ato gjinore, racore, orientimi seksual, statusi martesor, ngjyre, gjuhe, religjioni, mendimi politik ose tjetër, origjine kombëtare, etnike ose shoqërore, shoqërimi me ndonjë komunitet kombëtar, statusi prone, lindjeje ose tjetër.

Neni 4

4.1 Universiteti ka statusin e personit juridik me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij, duke përfshirë:

a) të drejtën e padisë;

b) të drejtën e pronës së paluajtshme dhe asaj individuale, përfshirë këtu të drejtat mbi pronësinë intelektuale, të dhuruara osë të fituara në emër të tij;

c) të drejtën për të miratuar flamurin, vulat dhe emblema tjera;

ç) të drejtën për të kufizuar përdorimin e titullit të Universitetit vetëm për personat ose organizatat për të cilat është dhënë autorizim nga Bordi.

4.2 Universiteti është regjistruar sipas dispozitave të ligjit mbi arsimin e lartë, më 19 nëntor 2001.

3. Universiteti ka vulën e vetë. Vula përmban emrin e plotë të Universitetit në të tri gjuhët.
3. Universiteti mund të bëjë marrëveshje me Fondacionin e UEJL sa i takon shfrytëzimit të kapitalit që është pronë e Fondacionit.
4. Asnjë fakultet ose njësi tjetër e Universitetit nuk ka statusin e personit juridik dhe nuk mund të posedojë ose të shesë asnjë lloj prone të paluajtshme ose individuale, ose të drejtat e pronësisë intelektuale. Fakultetet dhe njësitë tjera kanë autonominë që përcaktohet me këtë Statut.

Neni 5

Universiteti ka autonominë e tij sipas ligjit, sa i takon punës akademike në mësimdhënie, hulumtim dhe komunikim publik. Sipas dispozitave të këtij Statuti, Universiteti ka të drejtë:

1. të planifikojë dhe përcaktojë përmbajtjen dhe strukturën e programeve akademike, shkencore, artistike dhe profesionale të mësimdhënies dhe hulumtimit;
2. të përcaktojë metodologjinë e përdorur të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
3. të zgjedhë zyrtarët e vet akademikë;
4. të emërojë, të rregullojë punësimin ose largimin nga puna të profesorëve, stafit tjetër akademik dhe atij ndihmës;
5. të pranojë studentë dhe të përcaktojë kushtet e këtij pranimi;
6. të ndajë grada dhe diploma dhe, për shkaqe të arsyeshme, t'ua shfuqizojë të njejtat personave të cilëve ua ka ndarë;
7. të ndajë tituj shkencorë dhe tituj nderi;
8. të rregullojë organizimin e brendshëm.

Neni 6

Organet udhëheqëse të Universitetit janë Bordi i Universitetit, Rektori, Senati dhe Këshilli i Rektorit.

Pjesa II: Bordi i Universitetit

Neni 7

1. Sipas dispozitave të nenit 93.2, anëtarët e Bordit të Universitetit do të emërohen nga Bordi në momentin e përfundimit të mandatit të një apo më tepër anëtarëve dhe do të përbëhet nga:
 1. Tre anëtarë që nuk janë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
 2. Tre anëtarë, shtetas të Republikës së Maqedonisë, pjesëtarë të stafit të Universitetit me orar të plotë pune, të nominuar nga Senati;
 3. Tre anëtarë, që nuk janë personel apo studentë të Universitetit, e që reflektojnë llojllojshmërinë etnike dhe gjinore në Republikën e Maqedonisë dhe që nuk janë të përjashtuar nga trupat udhëheqëse të ndonjë Universiteti sipas ligjit mbi arsimin e lartë.

7.2 Kryetari i Unionit të Studentëve mund të merr pjesë në mbledhjet e Bordit të Universitetit dhe diskutime që kanë të bëjnë me studentët por pa të drejtë vote.

7.3 Të gjithë anëtarët e Bordit të Universitetit duhet të kenë pasur përvojë dhe të kenë treguar kapacitet sa u takon çështjeve profesionale, komerciale ose të punësimit, apo ushtrimit të çfarëdo profesioni, apo të kenë pasur përvojë në fushën e arsimit të lartë.

7.4 Kryetari dhe nën-kryetari i Bordit do të zgjidhen nga Bordi i Universitetit nga anëtarët e tij.

7.5 Bordi i Universitetit mund të kooptojë edhe një anëtar shtesë pa të drejtë vote me mandat 4 vjeçar.

7.6 Bordi i Universitetit mund të ftojë anëtarë shtesë të Senatit të zgjedhur nga fakultetet, të cilët nuk janë përfaqësuar në anëtarësinë në nenin 7.1.2 si anëtarë pa të drejtë vote.

Neni 8

1. Çdo anëtar i Bordit të Universitetit ka mandat katërvjeçar, me mundësi për ripërtrirje të të njëjtit edhe për katër vjet të tjera, me kusht që nuk mund të emërohet ose ri-emërohet askush që ka mbushur 70 vjet.

2. Kohëzgjatja e mandatit të kryetarit dhe nënkryetarit duhet të korrespondojë me atë të anëtarësisë në Bordin e Universitetit, ose të mbarojë me vdekjen, dorëheqjen ose pushimin e tyre nga detyra, ashtu siç përcaktohet më poshtë.
3. Anëtari i emëruar sipas nenit 7.1 apo dispozitave të këtij neni, mund të pushohet nga detyra me vota të dy të tretës së trupit emërues, me arsye të fortë, që definohet si:
 1. akuzë për kundërvajtje serioze kriminele të bazuar në ligjet e Republikës së Maqedonisë;
 2. sjellje që do të ishte diskredituese për Universitetin;
 3. paaftësi për të kryer funksionin e postit për shkak të mungesës së kapacitetit fizik apo mental, të vërtetuar me çertifikatë të pavarur mjekësore të dhënë nga mjeku që do të caktohet nga trupi emërues; dhe
 4. dështim, refuzim i vazhdueshëm, neglizhencë, ose paaftësi për të kryer detyrat e postit.
5. Sipas dispozitave të ligjit, pa paragjykime, dëmshpërblim nga mjetet e Universitetit kanë të drejtë të gjithë anëtarët e Bordit, rektori, sekretari i përgjithshëm, ose auditi i brendshëm i Universitetit; kundrejt çdo humbjeje, ose detyrimi, që atij/asaj mund t'i ndodhë, ose mund ta pësojë gjatë kryerjes së obligimeve në punë. Në përgjithësi, çdo pësim nga ai/ ajo në punë; seancë gjyqësore, qoftë civile ose penale, në të cilën jepet vendimi në favor të tij/asaj ku ai/ajo shfajësohen, ose lirohen nga gjykata për neglizhim ndaj detyrimeve, pakujdesi, keqpërdorim të detyrës, ose keqpërdorim të besimit në lidhje me punët e Universitetit.

Neni 9

1. Kryetari do të udhëheqë Bordin e Universitetit.
2. Nënkryetari do të udhëheqë Bordin e Universitetit në mungesë të kryetarit dhe do të ushtrojë të gjitha detyrat tjera të Kryetarit në rast sëmundjeje apo pamundësie tjetër.
3. Kryesuesi i mbledhjes së Bordit të Universitetit, do të ketë të drejtën e votës së drejtpërdrejtë dhe asaj vendimtare.
4. Anëtarët e Bordit të Universitetit, shtetas të huaj, mund të marrin pjesë në aktivitetet e Bordit edhe në forma tjera që nuk përfshijnë pjesëmarrjen fizike, e që do të përshkruhet me një rregull të sjellur nga vetë Bordi i Universitetit.

Neni 10

1. Bordi i Universitetit do të caktojë një Komitet Ekzekutiv të përbërë nga:

1. Kryetari i Bordit të Universitetit, që do ta udhëheqë atë;
2. Nënkryetari i Bordit të Universitetit;
3. Një prej anëtarëve tjerë, i emëruar sipas nenit 7.1 (1);
4. Një anëtar tjetër.

2. Mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv mund të thirren nga:

1. Kryetari i Bordit të Universitetit;
 2. Rektori;
 3. Shumica e anëtarëve të Bordit të Universitetit.
3. Komiteti Ekzekutiv do të ketë pushtet dhe obligime brenda Bordit aq sa do t'i jepen atij nga ana e vetë Bordi, dhe do t'i raportojë Bordit të Universitetit në çdo mbledhje të mbajtur.
 4. Udhëheqësi i Komitetit Ekzekutiv do të ketë të drejtën e votës së drejtpërdrejtë dhe asaj vendimtare.
 5. Cilido anëtar i Komitetit Ekzekutiv, shtetas i huaj, mund të marrë pjesë në aktivitetet e komitetit edhe në forma tjera që nuk përfshijnë pjesëmarrjen fizike, e që do të përshkruhet me një rregullore të sjellur nga vetë Bordi i Universitetit.

Neni 11

11.1 Sekretari i përgjithshëm i Universitetit do të jetë njëkohësisht edhe sekretar i Bordit dhe i Komitetit Ekzekutiv.

11.2 Në cilësinë e tij në paragrafin (1) të këtij neni, Sekretari i përgjithshëm ka të drejtën e mbajtjes së kontakteve të drejtpërdrejta me Kryetarin dhe nënkryetarin e Bordit të Universitetit.

Neni 12

Bordi i Universitetit, në përputhje me këtë Statut, mund të themelojë organe tjera, komitete dhe komisione për detyra të veçanta dhe t'i shpërbëjë të njëjtat.

Neni 13

Sipas ligjit, Bordi i Universitetit do të jetë organi menaxhues i Universitetit.

Neni 14

1. Sipas dispozitave të këtij Statuti dhe ligjit, Bordi i Universitetit do t'i ketë këto përgjegjësi:

1. Formësimin e karakterit të përgjithshëm arsimor dhe misionin e Universitetit duke përfshirë hulumtimin, studimin dhe mësimdhënien, me propozim të Rektorit ose Senatit, ose në konsultim me të njëjtët, dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të vazhdueshme të Universitetit;
2. Miratimin e procedurave për emërime, ngarkime, dhënie titujsh, lëvdatash, suspendim, pushim nga puna dhe përcaktim të pagave dhe kushteve të shërbimit për anëtarët e stafit dhe, sipas dispozitave të këtij Statuti, miratimin e kuadrove të larta.
3. Shqyrtimin, dhe po u pa e arsyeshme, edhe miratimin e vlerësimeve vjetore të të ardhurave, harxhimeve dhe llogarive të Universitetit, të përgatitura nga Rektori dhe të pranuar nga Bordi, në përputhshmëri me ligjin;
4. Marrjen e masave për të siguruar shfrytëzimin efektiv të burimeve, pasurinë e Universitetit dhe mbrojtjen e pronës së tij duke përfshirë edhe strategjinë për menaxhim të rrezikut;
5. Planifikimin për të siguruar burime adekuate nga sektori publik dhe privat, duke përfshirë edhe themelimin, sipas ligjit, e kompanive subsidiare për të shfrytëzuar komercialisht punën akademike të Universitetit.
6. Mbikëqyrjen e mbajtjes së shënimeve të përpikta mbi të ardhurat dhe harxhimet e Universitetit.
7. Aprovimin e një skeme për bartjen e autoritetit mbi burimet dhe çështjet tjera administrative të fakultetëve dhe njësitëve tjera të Universitetit.
8. Rregullojë revizionin financiar siç përcaktohet në vijim;

dhe do të jetë detyrë e Bordit të Universitetit:

1. Pas konsultimeve me përfaqësuesit e stafit dhe me konsideratë ndaj detyrimit

të Bordit për të siguruar që stafi akademik i Universitetit të ketë lirinë brenda ligjit të vë në pyetje dhe testojë urtësinë e pranuar si dhe të shpalosë ide të reja apo mendime kontraverse dhe jo të popullarizuara, pa mos u vënë në rrezik të humbjes së punës apo privilegjeve tjera që mund t'i gëzojnë në universitet, të nxjerrë rregullore që kanë të bëjnë me:

- I. Sjelljen e personelit;
 - II. Procedurat për t'u mundësuar anëtarëve të stafit të kërkojnë dëmshpërblim për çfarëdo padrejtësie që ka të bëjë me punësimin e tyre;
 - III. Suspendimin dhe pushimin e anëtarëve të stafit;
 - IV. Ankesën kundër një suspendimi apo pushimi të tillë.
2. Të përcaktojë pagesën për shkollim dhe pagesa tjera që i bëhen Universitetit;
 3. Të përpilojë rregullore të atilla që kanë të bëjnë me qeverisjen, sjelljen dhe menaxhimin e Universitetit, siç mund të kërkohej nga ky Statut, apo siç mund të jetë e dëshirueshme dhe konsistente brenda tij;
 4. Të mbështesë dhe të sigurojë që të gjitha pjesët e Universitetit të përkrahin barazinë dhe mundësitë për punësim, si dhe qasje të barabartë ndaj studimeve dhe hulumtimit, pavarësisht gjinisë, racës, orientimit seksual, statusit martesor, ngjyrës, përkatësisë së ndonjë pakice etnike apo kombëtare, besimeve politike ose religjioze, dhe, aq sa do të konsiderohej praktike në mënyrë të arsyeshme, moshës, dobësimin fizik ose mental.
 5. Të sillen në përputhje me standardet më të larta të vetë-sakrificës, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, çiltërsisë, ndershmërisë, dhe udhëheqësisë: gjatë realizimit të detyrave të tyre, asnjë anëtar nuk do të sillen si delegat i ndonjë grupi të caktuar e as nuk do të kërkojë ose të pranojë çfarëdo mandati: të gjithë anëtarët duhet të sillen gjatë gjithë kohës vetëm në mbrojtje të interesave të Universitetit si tërësi; dhe
 6. Të vendosë për formën dhe përmbajtjen e flamurit, stemës, dhe diplomës në pajtueshmëri me ligjet në Republikën e Maqedonisë.

2. Çfarëdo vendimi i Bordit të Universitetit për çështjet në vijim do të kërkojë shumicën prej tre të katërtave e votave të anëtarëve prezentë, përfshirë këtu së paku edhe një anëtar i emëruar sipas secilës prej dispozitave të nenit 7.1 (1) dhe 7.1 (3):

1. Ndryshimin e këtij Statuti;
2. Mbylljen, bashkimin apo transformimin e këtij Universiteti;
3. Emërtimin, suspendimin, ose shkarkimin e Rektorit sipas nenit 16 dhe 21;
4. Çështje tjera të përcaktuara nga vetë Bordi i Universitetit.

Neni 15

15.1 Procedurat e mbledhjeve të Bordit të Universitetit do të caktohen nga vetë Bordi me këshillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

15.2 Bordi i Universitetit dhe Komiteti Ekzekutiv i tij mund t'i delegojnë detyrime, sipas kushteve që do t'i përcaktojnë vetë ata, dhe t'i revokojnë të njëjtat, kryetarit të Bordit të Universitetit, po qe se kjo do të shkonte në dobi të Universitetit.

Pjesa III: Rektori dhe Pro-rektorët

Neni 16

16.1 Rektori, do t'i përgjigjet Bordit të Universitetit për punën efikase dhe rendin në universitet, si dhe për menaxhimin e Universitetit sipas politikave të përcaktuara nga Bordi i Universitetit.

16.2 Sipas nenit 14.2 c, Rektori, duhet të emërohet nga Bordi i Universitetit nga lista e shkurt nga tre kandidatë të verifikuar në Senat. Procedura për emërimin e Rektorit duhet të caktohet nga vetë Bordi i Universitetit.

16.3 Emërimi do të bëhet për periudhë katër vjeçare, me mundësi ripërtrijeje edhe për një mandat, por Bordi i Universitetit mund të lidh kontratë për ripërtrije të përkohëshme të mandatit të Rektorit deri dy vite, me qëllim të planifikimit dhe trajnimit më efikas.

16.4 Rektori nuk mundet në të njëjtën kohë të jetë edhe dekan i ndonjë fakulteti, drejtor, apo në çfarëdo pozite tjetër udhëheqëse (përveç pozitës së drejtorit të Fondacionit të Universitetit E.J.L siç është përcaktuar në Statutin e Fondacionit) ose pozitë tjetër e cila sipas dispozitave të ligjit është jokompatibile me mandatin e Rektorit të Universitetit.

16.5 Rektori, si zyrtar më i lartë akademik në Universitet, do të udhëheqë me Senatin dhe Këshillin e Rektorit, dhe do të ketë të drejtën të ndjekë të gjitha mbledhjet e Bordit

dhe Komitetit Ekzekutiv (përveç rasteve kur në ato mbledhje do të diskutohen çështje personale që kanë të bëjnë me vetë Rektorin).

16.6 Rektori ka përgjegjësi ligjore në pajtim me ligjin i cili i përshtatet Universitetit si institucion i arsimit të lartë private-publik jofitimprurës dhe dispozitat e këtij Statuti.

16.7 Rektori do t'i ketë të gjitha të drejtat për të mundësuar realizimin e detyrimeve të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni. Në veçanti Rektori do të jetë përgjegjës për:

1. prezantimin e propozimeve para Bordit të Universitetit sa i takon karakterit arsimor dhe misionit të Universitetit, duke marrë parasysh rekomandimet dhe mendimet e Senatit dhe Këshillit të Rektorit;
2. implementimin e vendimeve të Bordit të Universitetit dhe Komitetit Ekzekutiv;
3. organizimin, udhëheqjen dhe menaxhimin e Universitetit dhe stafit;
4. përgatitjen e vlerësimeve vjetore të të hyrave dhe harxhimeve, që do të rishikohen nga Bordi i Universitetit, si dhe menaxhimin e buxhetit dhe burimeve brenda vlerësimeve që do t'i aprovojë Bordi i Universitetit.

16.8. Rektori me vendim të Bordit të Universitetit gjithashtu mund të emërohet si Kryetar i Universitetit. Në këtë rast Pro-rektorët dhe Sekretari i përgjithshëm Nënkyetar dhe Nënkyetar i administratës respektivisht.

Neni 17

17.1 Bordi i Universitetit me emërimin e Rektorit mund të caktoj numrin e prorektorëve. Prorektorët do të asistojnë dhe përfaqësojnë Rektorin në përmbushjen obligime të tij.

17.2 Prorektorët do të caktohen nga Bordi i Universitetit me propozim të Rektorit, nga stafi akademik i Universitetit, të cilët nuk janë të pamundësuar nga dispozitat e ligjit për të marrë këtë post.

17.3 Emërimi i prorektorëve bëhet me mandat katërvjeçar, me mundësi ripërtrirjeje edhe për një mandat, por Bordi i Universitetit mund të lidh kontratë për ripërtrirje të përkohëshme të mandatit të pro-rektorëve në periudhë deri dy vite , me qëllim të planifikimit dhe trajnimit më efikas ose mandati i prorektorit do të rreshtohet me mandatin e Rektorit.

17.4 Pro-rektorët mund të jenë dekanët e fakulteteve apo drejtorët e qendrave dhe si të tillë, ata mund t'i mbajnë edhe pozitat ekzistuese në të njëjtën kohë në cilësi të ushtruesit të detyrës për atë periudhë kohore të caktuar nga Bordi i Universitetit ose Komitetit Ekzekutiv.

17.5 Një pro-reaktor, i emëruar nga Rektori, pas konsultimeve me kryetarin e Bordit, do të caktohet zëvendës-reaktor, i cili në këtë cilësi mund të jetë nën-kryetar i Senatit dhe Këshillit të Rektorit, dhe në këtë cilësi do të ketë të drejtën të ndjekë të gjitha mbledhjet e Bordit dhe Komitetit Ekzekutiv (përveç rasteve kur në ato mbledhje do të diskutohen çështje personale që kanë të bëjnë me vetë pro-reaktorin), mund të marrë autorizimin nga Rektori për ta përfaqësuar atë ligjërisht brenda dhe jashtë Universitetit, dhe, në raste të padisponueshmërisë apo pamundësisë së Rektorit, do të ushtrojë të gjitha detyrat e tij sipas ligjit dhe dispozitave të këtij Statut.

17.6 Rektori do të kërkojë miratim nga Komiteti Ekzekutiv i Bordit që fusha të veçanta të planifikimit, zhvillimit dhe përpilimit të politikave dhe koordinimit të jenë përgjegjësi të pro-reaktorëve.

17.7 Pro-reaktorët do të udhëheqin me ato komitete apo komisione, siç do të përcaktohet nga Rektori, brenda kornizave të përgjegjësisë të tyre, por nuk do të kenë përgjegjësi sa i takon realizimit të vendimeve dhe politikave të Bordit të Universitetit, Senatit, Këshillit të Rektorit nga shërbimi profesional dhe administrativë i Universitetit, që mbikëqyret prej Sekretarit të përgjithshëm.

17.8 Mandati i pro-reaktorëve mund të mbarojë para kohe me dorëheqje ose largim me shumicën prej dy të tretave të votave nga Bordi i Universitetit, me arsye të fortë që definohet si:

1. akuzë për vepër penale të përcaktuara në Ligjet e Republikës së Maqedonisë;
2. sjellje që do të ishte diskredituese për Universitetin;
3. pamundësi për të kryer funksionin e postit për shkak të paaftësisë fizike apo mentale, të vërtetuar me raport mjekësor të pavarur të dhënë nga mjeku që do të caktohet nga Bordi i Universitetit; dhe
4. dështim, refuzim i vazhdueshëm, neglizhencë, ose paaftësi për të kryer detyrat e postit

Neni 18

Kryetari i Bordit të Universitetit mund të caktojë cilindo anëtar nga stafi akademik për të ushtruar të gjitha funksionet e Rektorit apo Pro-reaktorëve, në rast të pamundësisë së përkohëshme ose pamundësisë së kryerjes së detyrës nga ana e tyre

Pjesa IV: Shërbimet administrative dhe profesionale

Neni 19

19.1 Sekretari i përgjithshëm do të jetë në krye të shërbimit profesional dhe administrativ të Universitetit.

19.2 Sekretari i përgjithshëm i Universitetit do të emërohet nga Bordi i Universitetit, pas konsultimeve të bëra me Rektoren, dhe do të zgjidhet brenda atyre që posedojnë kualifikim dhe përvojë adekuate dhe së paku duhet të ketë magjistraturë në drejtësi, biznes ose administratë publike ose lëmi ekuivalente.

19.3 Sipas nenit 11.2, Sekretari i përgjithshëm do t'i përgjigjet, Rektorit lidhur me administrimin efikas, ekonomik të Universitetit. Në këtë rol, Sekretari i përgjithshëm do të jetë përgjegjës për të gjitha çështjet tjera që nuk janë nën kompetenca të organeve tjera apo zyrtarëve, apo paraprakisht të rregulluara nga Bordi i Universitetit ose Komiteti Ekzekutiv

19.4 Sekretari përgjithshëm mund të shkarkohet para mbarimit të kontratës me dorëheqje ose largim me shumicën prej dy të tretave të votave nga Bordi i Universitetit, me arsye të mirë që definohet si:

1. akuzë për vepër penale të përcaktuara në Ligjet e Republikës së Maqedonisë;
2. sjellje që do të ishte diskredituese për Universitetin;
3. pamundësi për të kryer funksionin e postit për shkak të paaftësisë fizike apo mentale, të vërtetuar me raport mjekësor të pavarur të dhënë nga mjeku që do të caktohet nga Bordi i Universitetit; dhe
4. dështim, refuzim i vazhdueshëm, neglizhencë, ose paaftësi për të kryer detyrat e postit.

Neni 20

20.1 Shërbimet profesionale dhe administrative të Universitetit përbëhen nga departamente të cilët i përgjigjen Sekretarit të përgjithshëm si në vazhdim:

Sekretariati (duke përfshirë Shërbimin juridik dhe Shërbimet sekretariale, Arkivi, Zyrën për marrëdhëniet me opinion publik, Zyrën për menaxhimin e cilësisë, Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare, Shërbimi i prokurimit, Shërbimi i përkthimit dhe interpretimit, Shërbimi i auditimit të brendshëm)

Departamenti i Shërbimit të Financave

Departamenti i Shërbimit Studentor dhe Regjistrat

Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Stafit

Departamenti i Menaxhimit të Ngrëhinave

Departamenti i Shërbimit TI

Departamenti i Informimit dhe Shërbimeve Bibliotekare

20.2 Sekretari i përgjithshëm do të krijojë një strukturë organizative, të aprovuar nga Rektori dhe Komiteti Ekzekutiv i Bordit të Universitetit, të përbërë nga personel me përvojë që do t'i ndihmojnë atij dhe do të jetë njëkohësisht përgjegjës për udhëheqjen dhe menaxhimin e atij stafi;

Pjesa IV: Senati

Neni 21

Senati do të jetë organi më i lartë akademik i Universitetit, përpos rasteve të posaçme të përmendura në këtë Statut.

Neni 22

Senati do të përbëhet nga:

- 1) Rektori;
- 2) Pro-rektorët;
- 3) Dekanët e fakulteteve dhe drejtorët e njësive tjera akademike;
- 4) Dy anëtarë të zgjedhur nga stafi akademik i çdo fakulteti ose njësie tjetër jashtë fakulteteve;
- 5) Një anëtar nga çdo fakultet që është student dhe zgjidhet nga vetë studentët e atij fakulteti;
- 6) Një anëtar i zgjedhur nga ana e stafit jo-akademik.

Neni 23

Studentët dhe anëtarët tjerë të Senatit që nuk kanë të drejtë vote nuk do të marrin pjesë në diskutimet që kanë të bëjnë me studentë individë apo anëtarë të stafit. Kjo dispozitë nuk cënon të drejtën e studentëve apo anëtarëve të stafit të diskutojnë lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me ta apo të përfaqësohen nga kushdoqoftë tjetër, pavarësisht statusit të tij/saj.

Neni 24

Rektori do të kryesoj me Senatin. Në mungesë të Rektorit, Pro-rektori, i caktuar nga Rektori, do të merr rolin e kryesuesit të Senatit sipas dispozitave të paragrafit 5 të nenit 17. Në mungesë të Rektorit dhe Pro-rektorit të caktuar nga ai, Senatin do t'a kryesoj ndonjë prej Pro-rektorëve më të moshuar. Përndryshe, Senati do të zgjedhë kryesues të mbledhjeve nga personat e renditur në paragrafin (3) të nenit 24.

Neni 25

Senati nëpërmjet Rektorit do këshillon Bordin e Universitetit, për zhvillimin e aktiviteteve akademike të Universitetit dhe burimeve të nevojshme, duke përfshirë këtu edhe krijimin, bashkimin, ose shuarjen e departamenteve, dhe do të jetë përgjegjës për:

1. diskutimet rreth çështjeve të përgjithshme që kanë të bëjnë me punën hulumtuese-shkencore, studimin, mësimdhënien, dhe lëndët mësimore të universitetit;
2. përmbajtjen e plan-programit me rekomandimin e Këshillave të fakulteteve;
3. në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi arsimin e lartë, me rekomandim nga Këshillat e fakulteteve përcaktimin e aktiviteteve arsimore të Universitetit që duhen mbajtur në gjuhën shqipe, maqedonase, dhe gjuhët ndërkombëtare;
4. krijimin e procedurave për të siguruar cilësi akademike duke përfshirë caktimin e një Komisioni për evaluim dhe miratimin e doracakëve për evaluim në përputhje me Ligjin mbi arsimin e lartë.
5. implementimin e procedurave për të siguruar standarde akademike dhe miratimin dhe rishikimin e lëndëve mësimore;
6. Përcaktimin e numrit të studentëve që do të regjistrohen dhe kriteret për praninë, me rekomandim të Këshillit të Rektorit;
7. Politikën, kriteret, dhe procedurat e vlerësimit dhe kontrollit të performancës akademike të studentëve, me rekomandim të Këshillit të Rektorit;
8. Dhënien e titujve, diplomave dhe çertifikatave, me rekomandim të Këshillave të fakulteteve;
9. Përcaktimin e dispozitës për mësim të përjetshëm me rekomandim të Këshillit të Rektorit;
10. Procedurat për dhënien e kualifikimeve dhe titujve akademikë të nderit;
11. Procedurat për përjashtim të studentëve për arsye akademike dhe të tjera;
12. Shqyrtimin e politikës për mbrojtjen e pronësisë intelektuale të Universitetit dhe shfrytëzimin komercial të saj;
13. Dispozitën për këshillëdhënie për çështje të tjera, për të cilat Bordi i Universitetit, Komiteti Ekzekutiv, Rektori ose Këshilli i Rektorit mund t'i drejtohen Senatit.
14. Sipas nenit 16.2 të verifikon, një listë të shkurtër të kandidatëve për pozitën e Rektorit.

Senati mund të formojë Komitete ose Komisione që do t'a këshillojnë atë për çështje të posaçme të punës së tij dhe mund t'ia bartë cilat do kompetenca Këshillit të Rektorit.

Neni 27

Procedurat për mbledhjet e Senatit dhe komiteteve apo komisioneve të tij do të rregullohen nga vetë Senati pas marrjes së miratimit të Bordit të Universitetit.

Neni 28

Një kod pune për mbarëvajtjen e aktiviteteve të Senatit do të përgatitet dhe miratohet në formë të një rregulloreje të Bordit të Universitetit. Kjo përfshin procedurat për thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjeve, formimin e komiteteve, evidentimin e vendimeve dhe çështjeve tjera relevante.

Pjesa V: Këshilli i Rektorit

Neni 29

29.1 Këshilli i Rektorit përbëhet nga Rektori, prorektorët, Sekretari i përgjithshëm, dekanët e fakulteteve dhe drejtorëve të atyre njësive tjera akademike, siç do të përcaktojë Bordi i Universitetit.

29.2 Kryetari i Unionit të studenteve mund të ndjekë mbledhjet e Këshillit të Rektorit dhe të marrë pjesë në diskutime për çështje të studenteve pa të drejtën e votës.

Neni 30

Kompetencat e Këshillit të Rektorit do të jenë:

1. të veprojnë si kanal komunikimi i rregullt dhe frekuentues ndërmjet anëtarëve të tij dhe Senatit, Rektori dhe Bordit të Universitetit bashkë me Komitetin Ekzekutiv të tij.
2. të marrë vendime mbi çështjet akademike që i janë deleguar nga Senati dhe t'i dorëzoj raport Senatit për të njejtat;
3. të marrë vendime mbi çështjet urgjente akademike dhe t'i raportojë Senatit për të njejtat;
4. me propozim të Rektorit të miratojnë datat e sesioneve, periudhave të regjistrimit, pushimeve, dhe afateve të provimeve;

5. me rekomandim të Këshillave të fakulteteve të aprovojë caktimin e detyrave të mësimdhënies për stafin akademik;
6. me rekomandim të Këshillave të fakulteteve të emërojë dhe shkarkojë vlerësuesit;
7. të veprojë si forum për planifikim, rregullim dhe sigurimin e burimeve për qëllime akademike;
8. të përgatitë çështjet për shqyrtim nga Senati, Bordi i Universitetit ose Komiteti Ekzekutiv.
9. të përgatitë komente mbi propozimet e bëra nga Rektori e që duhen shqyrtuar nga Senati, Bordi i Universitetit ose Komiteti Ekzekutiv.
10. t'i realizojë të gjitha funksionet tjera të Këshillit të Rektorit të përcaktuara me këtë Statut.

Neni 31

Procedurat e mbledhjeve të Këshillit të Rektorit i rregullon vetë Këshilli i Rektorit me miratim të Komitetit Ekzekutiv të Bordit të Universitetit.

Neni 32

Rregullorja për punën e Këshillit të Rektorit do të përgatitet dhe miratohet në formë të një rregulloreje të Bordit të Universitetit. Kjo nënkupton procedurat për thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjeve, shënimin e vendimeve, arkivimin dhe çështjet tjera relevante.

Pjesa VII: Fakultetet

Neni 33

Fakultetet janë njësi organizative brenda Universitetit që realizojnë veprimtari hulumtuese-shkencore në fushë konkrete akademike apo lëmi të përafërt duke vepruar nëpërmjet Këshillit të fakultetit dhe në kuadër të politikave të Universitetit të miratuara nga Bordi i Universitetit ose Komiteti Ekzekutiv dhe janë përgjegjës si në vijim:
1) të japë propozime para Senatit për çështje akademike që kanë të bëjnë me lëndët që ligjërohen në fakultetet;

- 2) mësimdhënien, kontrollimin dhe vlerësimin e studentëve;
- 3) çështjet lidhur me përparimin akademik të studentëve;
- 4) çështjet lidhur me angazhimin e stafit, siç përcaktohet me këtë Statut;
- 5) përdorimin përkatës dhe efikas të burimeve të ndara nga Bordi i Universitetit ose Komiteti Ekzekutiv;

Neni 34

Numrin e fakulteteve të Universitetit e cakton Bordi i Universitetit me propozim të Senatit dhe Këshillit të Rektorit, ose me konsultime paraprake me Senatin dhe Këshillin e Rektorit. Bordi i Universitetit mund t'i shkrij ose bashkoj me njëri-tjetrin fakultetet e krijuara.

Neni 35

Numri i departamenteve dhe stafit në secilin fakultet do të caktohet nga Bordi i Universitetit me propozim të Rektorit ose me konsultime paraprake me Rektorin.

Neni 36

Çdo fakultet do të udhëhiqet nga dekani i cili, me aprovim nga Komiteti Ekzekutiv i Bordit të Universitetit, do të ndihmohet nga një apo më tepër pro-dekanë.

Neni 37

37.1 Dekanët dhe Pro-dekanët e fakulteteve do të emërohen nga Komiteti Ekzekutiv i Bordit të Universitetit. Rektori do ti nominoj kandidatët për dekan për një periudhë katërvjeçare nga lista e përpiluar nga Këshilli i Fakultetit, nga radhët e stafit akademik nga lëndët që ligjërohen në fakultetin përkatës.

37.2 Pro-dekanët do të emërohen nga Rektori duke ndjekur nominimin e dekanit të fakultetit

37.3 Kandidatët për Dekan dhe Pro-dekanë të fakulteteve, që duhet të nominohen, duhet të jenë persona me kualifikim dhe përvojë relevante akademike dhe menaxheriale.

37.4 Kandidatët për Dekan apo Pro-dekanë nuk mundën njëkohësisht të jenë edhe kandidatë për postin e Rektorit.

37.5 Procedura e nominimit do të përshkruhet me një rregullore të Bordit të Universitetit dhe do të përfshijë konsultime me Këshillin e fakultetit përkatës.

Neni 38

Dekani i fakultetit do t'i përgjigjet Rektorit dhe nëpërmjet tij, edhe Bordit të Universitetit. Detyrat e Dekanit do të jenë si vijon:

- 1) të sigurojë udhëheqje akademike në mësimdhënie dhe hulumtime shkencore;

- 2) të kujdeset për shfrytëzimin efikas dhe ekonomik të mjeteve të ndara për fakultetin nga ana e Bordit të Universitetit;
- 3) t'a përfaqësojë fakultetin në Këshill e Rektorit dhe Senat;
- 4) t'a këshillojë Rektorin lidhur me emërimin e anëtarëve të stafit akademik për lëndët që mësohen në fakultet;
- 5) të kujdeset për zbatimin respektimin e të gjitha rregulloreve të Universitetit të në fakultet;
- 6) të realizojë edhe detyra tjera si Dekan i fakultetit, të përcaktuara në këtë Statut.

Neni 39

Dekani i një fakulteti mund të veprojë vetëm në emër të Universitetit ose për çështje juridike në emër të fakultetit, me leje eksplicite nga Bordi i Universitetit i dhënë nëpërmjet Rektorit.

Neni 40

Dekani i fakultetit i përcakton detyrimet e Pro-dekanëve.

Neni 41

41.1 Çdo fakultet do të ketë Këshillin mësimor – shkencor (Këshilli i fakultetit), me të cilët udhëheq dekani, ose në mungesë të tij, njëri prej Pro-dekanëve.

41.2 Këshilli i fakultetit do të përbëhet nga:

(i) Dekani dhe pro-dekanët e Fakultetit

(ii) I tërë stafi akademik i me thirrje akademike docent e më lartë

(iii) Dy bashkëpunëtor të zgjedhur nga dhe radhët e bashkëpunëtorëve të fakultetit përkatës.

(iv) Një anëtarë nga stafi akademik me angazhim part-time (orar jo-të plotë) me thirrje akademike docent e me lartë i zgjedhur nga dhe radhët e stafit akademik me angazhim part-time.

(v) Nga një përfaqësues të studentëve për secilin vit studimor, duke përfshirë edhe studimet e ciklit të dytë dhe të tretë, të zgjedhur nga radhët e grupeve përkatëse të studentëve të atij fakulteti përkatës.

41.3 Këshilli i fakultetit mund të diskutojë dhe japë mendim për çfarëdo çështje që ka të bëjë me punën e fakultetit.

41.4 Sipas nenit 41.5 Këshilli i fakultetit do të jetë trup këshillëdhënës i Dekanit të fakultetit.

41.5 Këshilli i Fakultetit do të jetë përgjegjës për t'i propozuar Senatit emrat e personave për t'u zgjedhur në tituj shkencor dhe votimi i këtillë duhet të kufizohet vetëm për ata që mbajnë titullin e njëjtë akademik ose më të lartë.

Neni 42

Mandati i Dekanit apo Pro-dekanit, i caktuar në këtë pjesë, mund të përfundojë para kohe me dorëheqje ose largim nga posti me votat e dy të tretave të anëtarëve të Bordit të Universitetit, me arsye të fortë që definohet si:

1. akuzë për vepër penale të përcaktuara në Ligjet e Republikës së Maqedonisë;
2. sjellje që do të ishte diskredituese për Universitetin;
3. pamundësi për të kryer funksionin e postit për shkak të paaftësisë fizike apo mentale, të vërtetuar me raport mjekësor të pavarur të dhënë nga mjeku që do të caktohet nga Bordi i Universitetit; dhe
4. refuzim i vazhdueshëm i detyrave të përcaktuara.

Pjesa VIII: Njësitë tjera akademike

Neni 43

43.1 Numri dhe funksioni i njësive tjera akademike të Universitetit (institutet kërkimore, qendrat, etj.) do të caktohet nga Bordi i Universitetit me propozim apo pas konsultimeve me Rektorin. Njësitë e krijuara në këtë mënyrë mund të jenë pjesë e një fakulteti ose të jenë të pavarura, dhe mund të shkrihen, bashkohen apo transferohen ndërmjet fakulteteve me pëlqim të Bordit të Universitetit.

43.2 Për qëllime të zgjedhjes në tituj akademik dhe çështje të ngjashme që kanë të bëjnë me stafin akademik dhe të rregulluara me ligj, secila njësi akademike do të mbështetet në fakultetin përkatës; Këshillat e Fakulteteve brenda atyre fakulteteve do të kenë autoritetin themelor, sipas nenit 41, i mbështetur nga stafi akademik i njësisë akademike, që kanë titullin e njejtë ose më të lartë nga ata që propozohen për zgjedhje.

Neni 44

Secila njësi akademike e themeluar me këtë pjesë, do të jetë pjesë integruese e Universitetit dhe asnjëra prej tyre nuk do të ketë statusin e personit të pavarur juridik.

Neni 45

Numri i departamenteve dhe vendeve të punës në secilën njësi organizative do të përcaktohet nga Bordi i Universitetit me propozim të Rektorit.

Neni 46

Secila njësi organizative do të udhëhiqet nga një drejtor që mund të jetë Dekan apo Pro-dekan i fakultetit përkatës, ose cilido anëtar tjetër i stafit akademik me titull shkencor magjistër dhe më lartë.

Neni 47

Drejtorët emërohen sipas rregullave për emërim të përshkruar nga Bordi i Universitetit apo Komiteti Ekzekutiv i tij me nominim nga Rektori.

Neni 48

Drejtori i një njësie akademike brenda fakultetit do t'i përgjigjet Dekanit të atij fakulteti, ose Rektorit. Detyrat e drejtorit do të jenë:

1. ta menaxhojë njësinë duke shfrytëzuar në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike mjetet të ndara për të nga Bordi i Universitetit;
2. ta përfaqësojë njësinë në Këshillin e fakultetit dhe në Senat;
3. ta këshillojë Dekanin e fakultetit ose Rektorin, sipas rregullave, lidhur me emërimin e anëtarëve të stafit brenda njësisë;
4. të realizojë detyrime tjera të Drejtorit të përcaktuara në Statut.

Neni 49

Drejtori i një njësie organizative mund të veprojë vetëm në emër të Universitetit, ose, për çështje juridike, në emër të njësisë me leje eksplicite nga Bordi i Universitetit, i dhënë nëpërmjet Rektorit.

Neni 50

Mandati i Drejtorit, i emëruar sipas kësaj pjesë, mund të përfundojë para kohe me dorëheqje ose largim nga posti me votat e dy të tretave të anëtarëve të Bordit të Universitetit, me arsye të fortë që definohet si:

1. akuzë për vepër penale të përcaktuara në Ligjet e Republikës së Maqedonisë;
2. sjellje që do të ishte diskredituese për Universitetin;
3. pamundësi për të kryer funksionin e postit për shkak të paaftësisë fizike apo mentale, të vërtetuar me raport mjekësor të pavarur të dhënë nga mjeku që do të caktohet nga Bordi i Universitetit; dhe
4. refuzim i vazhdueshëm i detyrave të përcaktuara.

Pjesa IX: Pranimi i studentëve

Neni 51

51.1 Pranimi i studentëve do të bëhet sipas Rregullores së miratuar nga Senati.

51.2 Gjithë kandidatët të cilët kanë kaluar maturën shtetërore ose maturën ndërkombëtare mund të pranohen për studime në Universitet . Kandidatët të cilët kanë kaluar maturën shkollëre mund gjithashtu të pranohen në studime në qoftë se numri i kandidatëve me maturë shkollëre është më i ulët se numri i paraparë nga Senati sipas paragrafit 6 neni 25.

51.3 Rregullorja do të përfshij dispozita që studentëve do t'ju mundësohet që të regjistrohen në studime të avansuara me kusht që çdo student i pranuar të ndjek

mësimin drejt marrjes së diplomës, detyrimisht të kryej një vit studimi ekuivalent me një vit studimi të rregullt akademik në universitet.

Pjesa X: Titujt akademik

Neni 52

52.1 Në përputhje me kushtet e kërkuara për akreditim të parapara në Ligjet e Republikës së Maqedonisë.

- Çertifikata dhe diploma universitare;
- Titullin e të diplomuarit (bachelor);
- Shkallë profesionale të ciklit të parë;
- Shkallën e magjistraturës;
- Shkallën e doktoraturës.

52.2 Shkallët e titujve, diplomave dhe çertifikatave do të përcaktohen nga Senati, ashtu që të jenë kompatible me praktikën ndërkombëtare profesionale dhe akademike dhe mund të ndryshojnë në varshmëri nga fakultetet.

52.3 Universiteti ka të drejtën të ndajë edhe shkallën, diplomën apo çertifikatën *honoris causae, ex officio* ose *ad eundem*.

52.4 Këshilli i Rektorit mund të ndajë titullin Anëtar nderi i Universitetit çdo personi që sipas Këshillit të Rektorit, ka dhënë kontribut të merituar për Universitetin por nuk i plotëson kriteret për të marrë titull akademik nderi.

Neni 53

Titujt akademikë do të jepen nga Senati, sipas dispozitave të këtij Statuti.

Neni 54

Bartësve të titujve mund t'u merren të njejtat nga Senati, me rekomandim të Këshillit të Rektorit apo Rektorit në qoftë se e sheh të arsyeshme për një gjë të tillë, me dëgjim paraprak të palës nga një person i pavarur, i emëruar nga Senati. Arsyet e mjaftueshme për këtë do të kishte qenë falsifikimi apo pandershmëria gjatë vlerësimit për të arritur

deri te titulli, përfshirë këtu edhe plagiatën, dhunimin e të drejtës autoriale, ose veprime tjera jo-etike gjatë përgatitjes së disertacionit apo temave tjera të shkruara.

Neni 55

55.1 Studimet për shkallën e të diplomuarit (bachelor – cikli i parë) përbëhen nga 180 ose 240 kredi me së paku, tre vjet (gjashtë semestra studimi), respektivisht katër vjet (tetë semestra), qofshin ato studime të rregullta apo me korrespondencë.

55.2 Çertifikatat dhe diplomat universitare mund të jepen pas kryerjes me sukses të studimeve me 60 ose 120 kredi, ashtu siç do të jetë e shënuar në shtojcën e diplomës relevante.

55.3 Studentët e ciklit të parë të studimeve deridiplomike duhet të përfundojnë studimet brenda periudhës maksimale që paraqet dyfishin e kohës së studimeve të përmendur në nenin 55.1.

55.4 Viti akademik fillon më 15 shtator dhe mbaron me 14 shtator të vitit të ardhshëm.

Neni 56

Mënyra e vlerësimit të performancës së studentëve në studimet për shkallën e studimeve deridiplomike është përcaktuar me Rregullore të përpiluar nga Senati.

Neni 57

57.1 Shkalla e magjistraturës (cikli i dytë) do të jepet pas mbarimit me sukses të studimeve ekuivalente me 60 'M' kredi, pasi të jenë mbaruar studimet e ciklit të parë ekuivalente me 240 kredi, ose 120 'M' kredi pas mbarimit të studimeve të ciklit të parë ekuivalente me 180 kredi, që nënkupton shkallën e të diplomuarit (Bachelor) të dhënë nga Universiteti ose nga ndonjë tjetër institucion i njohur nga Universiteti, në pajtueshmëri me ligjin.

57.2 Studentët e ciklit të dytë duhet t'i kryejnë studimet e tyre brenda periudhës maksimale që paraqet dyfishin e kohës së studimeve të përmendur në nenin 57.1.

57.3 Senati mund të lejojë kushte të posaçme për programet me korrespondencë, ekzekutive dhe format tjera të studimeve të magjistraturës.

Neni 58

Mënyra e vlerësimit të performancës së studentëve në studimet e magjistraturës është përcaktuar me Rregullore të përpiluar nga Senati.

Neni 59

Përmbajtja e programeve studimore për shkallën e të diplomuarit (bachelor) dhe për shkallën e magjistraturës do të përcaktohen me rregullore të përgatitura nga Dekanët e fakulteteve dhe të aprovuara nga Këshilli i Rektorit dhe Senati.

Pjesa XI: Realizimi i punës hulumtuese-shkencore dhe bursat

Neni 60

Studimet e doktoraturës (cikli i tretë) mund të fitohet me:

1. **pas kryerjes me sukses të studimeve e doktoraturës për një periudhë më së paku tri vite (180 ECTS) dhe pas marrjes së titullit Magjistër (cikli i dytë) goftë nga Universiteti ose ndonjë institucion tjetër i njohur nga Universiteti në përputhje me ligjin; dhe**
2. mbrojtjen me sukses të tezës ku do të jenë të përfshira të gjitha rezultatet punës hulumtuese-shkencore.

Disertacioni i doktoraturës duhet të dorëzohet për kontroll më së voni deri në fund të mbarimit të periudhës që është sa dyfishi i periudhës së studimeve në të cilën është regjistruar kandidati.

Neni 61

Mënyra e mbikëqyrjes së punës hulumtuese dhe organizimi i vlerësimit të kandidatëve për doktoraturë do të përcaktohet me një rregullore të përpiluar nga Senati, për të cilat duhet të aplikohet sistemi i kredive.

Neni 62

Përmbajtja e programit hulumtues për marrjen e titullit doktor shkence do të miratohet nga Këshilli i fakultetit në të cilin do të bëhet edhe pjesa më e madhe e punës kërkimore.

Neni 63

Anëtarët e stafit akademik ose staf ndihmës që kanë shkallë Magjistër mund të regjistrohen në program hulumtues-shkencor dhe bursë për marrjen e shkallës doktor shkencash, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga Senati.

Pjesa XII: Stafi akademik

Neni 64

64.1 Stafin akademik të Universitetit e përbëjnë personat që mbajnë thirrjet:

1. Profesorë ordinarë;
2. Profesorë inordinarë;
3. Asistent profesorë (Docent);
4. Lektor të lartë;
5. Lektor
6. Bashkëpunëtor;

dhe vendi i punës bazohet në kontratë me orar të plotë ose jo-të plotë (part-time) pune.

64.2 Personat të cilët sipas kontratës janë staf vizitues sipas dispozitave të ligjit do të konsiderohen si staf akademik për qëllime të këtij Statuti.

64.3 Bordi i Universitetit, me rregullore, mund t'i ndryshojë dispozitat e këtij neni në kuptim të stafit akademik të punësuar nëpër fakultete me thirrje të ndryshme që njihen ndërkombëtarisht.

64.4 Bordi i Universitetit, me rregullore, do të sigurojë harmonizimin e thirrjeve akademike të stafit të Universitetit në përputhje me ligjin.

Neni 65

Në përputhje me nenin 66,

(1) Profesorët ordinarë dhe inordinarë i emëron ose thirrjet e tyre i miraton Bordi i Universitetit, ose, nëse kërkojnë rrethanat Komitetit Ekzekutiv me rekomandim të Senatit dhe Rektorit.

(2) Emërimin e Asistent Profesorëve (docentët), lektor të lartë, lektorë dhe asistent/ bashkëpunëtor dhe miratimin e thirrjeve akademike e jep Senati me rekomandim nga Këshilli i fakultetit përkatës.

Neni 66

66.1 Të gjitha konkurset për emërimë do të shpallet në mënyrë publike.

66.2 Të gjitha emërimet për titullin akademik Profesor ordinar ose inordinar do të bëhen pas shqyrtimit të aplikacioneve nga një komision seleksionues i caktuar nga Senati; Komisioni do t'i intervistojë ata kandidatë që konsideron se i plotësojnë më së miri kushtet për punë.

66.3 Komisioni seleksionues i raporton Senatit.

66.4 Në rast të emërimit të asistent profesorëve (docentëve), lektor të lartë, lektorë dhe asistentëve/bashkëpunëtorëve, Dekani i fakultetit do të zgjedhë dhe propozojë një kandidat për t'u emëruar.

66.5 Emërimet mund të propozohen nga një apo më tepër fakultete bashkërisht.

66.6 Secili komision seleksionues për emërimin e profesorëve ordinarë do të përfshijë së paku një anëtar ndërkombëtar me përvojë të njohur në fushën përkatëse, i emëruar nga Senati me aprovim të Komitetit Ekzekutiv të Bordit të Universitetit.

Neni 67

Të gjitha komisionet seleksionuese do të përbëhen nga anëtarë të të dy gjinive, përveç rasteve të lejitimit eksplicit të Bordit të Universitetit ose Komitetit Ekzekutiv.

Neni 68

Askush nuk mund të jetë anëtar i komisionit seleksionues e që në të njëjtën kohë është bashkëshort, partner ose anëtar i familjes së ngushtë të cilit do prej kandidatëve që duhen emëruar. Çfarë nënkuptohet me "familje e ngushtë" do të përcakton Bordi i Universitetit.

Neni 69

Kushtet për emërimin dhe avansimin në të gjitha nivelet të stafit akademik do të varen nga posedimi i kualifikimit përkatës dhe përvoja relevante për postin.

1. Për thirrjen Profesor, aplikuesi duhet të ketë së paku shkallën e doktoraturës ose ekuivalente me të, të demonstrojë nivel të lartë njohurish dhe studimi nga lëmia përkatëse në të cilën zgjidhet, mbështetur me publikime në revista të njohura veçanërisht në ato ndërkombëtare, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe aktivitete tjera si dhe të jep prova për udhëheqësi akademike; në rast të një Profesori, i emëruar në lëminë e artit, i njëjti duhet të ketë mbajtur prezantime ndërkombëtare publike të punës së tij artistike, në ekspozita, muzikë, dramë, ose ngjashëm, të ketë kontribuar në nivel të lartë për zhvillimin e artit dhe kulturës, natyrisht, të ketë së paku titullin Magjistër ose ekuivalent me të dhe të dëshmojë aftësi menaxhuese akademike.
- (2) Për titullin Profesor inordinar ose Asistent profesor (docent) aplikuesi duhet së paku të ketë titullin doktor shkence ose ekuivalent me të, të ketë publikime në revista të njohura shkencore, veçanërisht ato ndërkombëtare, të ketë krijuar punë artistike ose të ketë mbajtur prezantime publike, të demonstrojë performancë të mirë në mësimdhënie, punime shkencore dhe nivel të lartë të njohurive në lëminë në të cilën zgjidhet, gjegjësisht në rastin e profesorit inordinar apo asistent profesori (docenti) i emëruar në një fushë artistike, kandidati duhet të jetë autor i veprave të

njohura artistike ose prezentimeve publike dhe të performancë të mirë në mësimdhënie.

3. Për titullin lektor i lartë, aplikuesi duhet të tregojë kompetencë në mësimdhënie dhe hulumtim, dhe duhet të ketë titullin Magjistër;
4. Për titullin lektor, aplikuesi duhet të ketë përvojë praktike në mësimdhënie dhe duhet të ketë titullin Magjistër.
5. Kandidatët për titullin bashkëpunëtor duhet të kenë titullin Magjistër dhe të jenë të regjistruar në studimet e doktoraturës (cikli i tretë) në Universitet ose në ndonjë institucion tjetër të njohur me ligj.

Neni 70

Të gjitha emërimet do të bëhen në baza të meritës akademike pa diskriminim mbi çfarëdo baze, si gjinie, race, orientimi seksual, statusi martesor, ngjyre, gjuhe, religjioni, bindjeve politike ose tjera, origjine nacionale, etnike ose shoqërore, shoqërimi me ndonjë komunitet nacional, statusi prone, prejardhje ose tjetër.

Neni 71

71.1 Emërimet e stafit akademik do të jenë me kohëzgjatje prej një viti, por mund të ripërtrihen nga ana e Rektorit me rekomandim të Senatit ose Këshillit të fakultetit, në përputhje me procedurat për emërimin fillestar.

71.2 Çdo anëtar i stafit akademik emërimi i të cilit është ripërtëritur në kohëzgjatje prej tre vitesh, përsëri mund të ripërtërihet nga Rektori në përputhje me kushtet e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni.

Neni 72

72.1 Një profesor i pensionuar mund të emërohet në postin e Profesor Emeritus nga ana e Bordit të Universitetit ose Komitetit Ekzekutiv; detyrat e profesorëve Emeriti do të përcaktohen me kontratë individuale të punës.

72.2 Bordi i Universitetit ose Komiteti Ekzekutiv gjithashtu mund ti ndajë titullin Emeritus personit të pensionuar i cili ka qenë në pozitën e Rektorit ose Pro-rektorit.

Neni 73

Skema për maksimum “një vit të lirë studimesh” (ndërprerje e përkohëshme e punës me qëllim studimi(sabbatical leave)) për stafin akademik do të përpilohet nga Bordi i Universitetit pas konsultimeve me Senatin.

Neni 74

74.1 Stafi akademik duhet të lidh kontratë pune me Universitetin dhe asgjë në këtë nen nuk do të ndikojë mbi të drejtat dhe obligimet përkatëse të punëdhënësit dhe punëtorit sipas kontratës dhe ligjit.

74.2 Stafi akademik vizitues duhet t'u përshtatet rregullave të Universitetit që kanë të bëjnë me kërkesat nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë për punësimin e shtetasve të huaj.

74.3 Bordi i Universitetit mund të shkarkojë Profesorët ordinarë nga pozita e tyre para përfundimit të kontratës nëse për këtë ekziston arsye e fortë.

74.4 Stafi tjetër akademik mund të shkarkohet nga postet e tyre nga ana e Rektorit para përfundimit të kontratës së tyre nëse vetë Rektori konsideron se për këtë ka arsye të fortë.

74.5 'Arsyeja e fortë' definohet si:

1. akuzë për vepër penale të përcaktuara në Ligjet e Republikës së Maqedonisë;
2. sjellje që do të ishte diskredituese për Universitetin; pamundësi për të kryer funksionin e postit për shkak të paaftësisë fizike apo mentale, të vërtetuar me raport mjekësor të pavarur të dhënë nga mjeku që do të caktohet nga Bordi i Universitetit;
3. pamundësi për të kryer funksionin e postit për shkak të paaftësisë fizike apo mentale, të vërtetuar me raport mjekësor të pavarur të dhënë nga mjeku që do të caktohet nga Bordi i Universitetit;
4. dështim, refuzim i vazhdueshëm, neglizhencë, ose paaftësi për të kryer detyrat e postit, që do të vlerësohej nga Bordi ose Rektorati; apo
5. tepriçë teknologjike sipas procedurave të drejta dhe të hapura të përcaktuara nga Bordi i Universitetit.

Neni 75

Bordi i Universitetit do të përpilojë Rregullore të procedurave që duhen ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënies të punës të stafit akademik sipas nenit të mësipërm.

Neni 76

Anëtarët e stafit me orar të plotë pune nuk mund të ndërmarrë aktivitete tjera pune jashtë Universitetit, përfshirë punën në kompani publike ose private, organizata, universitet tjetër apo institucion të arsimit të lartë brenda ose jashtë Republikës së Maqedonisë, pa leje paraprake nga Rektorati. Për dhënien e lejes Rektorati mund të shtojë çfarëdo kushti apo kërkesë sipas diskrecionit të tij.

Pjesa XIII: Të drejtat dhe obligimet e studentëve

Neni 77

Studentët e pranuar në universitet kanë të drejtë të:

1. të ndjekin ligjëratat, seminarët dhe lloje tjera mësimdhënieje të organizuara sipas lëndëve në drejtimet e tyre;
2. t'i shfrytëzojnë kapacitetet e bibliotekave të Universitetit dhe shërbimet tjera studentore;
3. të marrin pjesë në zgjedhje për pozitat e studentëve në organet e Universitetit;
4. të marrin kartë identiteti;
5. pa pagesë të marrin çertifikatat e notave në fund të çdo viti akademik.

Obligimet e tyre janë të:

1. respektojnë rregullat e Universitetit;
2. kenë konsideratë ndaj të drejtave të stafit dhe studentëve tjerë;
3. t'u kushtojnë kujdes të posaçëm studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
4. sillen mirë, qoftë brenda apo jashtë objekteve të Universitetit, ashtu që të mos diskreditojnë imazhin e Universitetit.

Neni 78

Studentët kanë të drejtë të ankohen për cilësinë e mësimdhënies ose çështjet tjera në universitet; ankesat e këtilla së pari duhet t'i bëhen të njohura Dekanit të fakultetit ose një zyrtari përgjegjës, me mundësi për ankimim te Rektori ose Komisioni i emëruar nga Rektori i cili sjell vendim përfundimtar. Me propozim të Rektorit, Bordi i Universitetit do të përpiloj Rregullore ku do të parashihen procedurat.

Neni 79

Këshilli i fakultetit mund të largojë nga studimet studentët që nuk kanë arritur të përparojnë në mënyrë adekuate në studimet e tyre. Ankimim mund t'i parashtrohet Komisionit të emëruar nga Senati, vendimi i të cilit është përfundimtar. Me propozim të Senatit, Bordi i Universitetit përpilon Rregullore për rregullimin e procedurave.

Neni 80

Studentët që sillen keq mund të përjashtohen nga Universiteti përjetësisht ose përkohësisht me vendim të Këshillit të Rektorit. Studentët e akuzuar për keqsjellje kanë të drejtën të dëgjohen nga Komisioni disiplinor i cili do t'a këshillojë Këshillin e Rektorit. Suspendimi deri në dëgjim mund të autorizohet nga Rektori ose Pro-rektori. Studentët e përjashtuar nga Këshilli i Rektorit mund të ankohen në Komitetin Ekzekutiv të Bordit të Universitetit, i cili mund ta konfirmojë ose ndryshojë vendimin e Këshillit të Rektorit. Me propozim të Këshillit të Rektorit, Bordi i Universitetit përpilon Rregullore për rregullimin e procedurave.

Pjesa XIII: Financat

Neni 81

Universiteti është njësi jo – fitimprurës. Fondet e tij mund t'i përfiton nga këto burime:

- i. donacione nga buxheti i shtetit i Republikës së Maqedonisë, nga autoritetet lokale dhe persona juridik brenda shtetit;
- ii. donacioneve dhe dhuratave nga individë, shoqata ose fondacione brenda dhe jashtë Republikës së Maqedonisë;
- iii. pagesave për shkollim dhe të tjerave të dhëna nga studentët;
- iv. mjeteve financiare nga hulumtimet ose këshillimet;
- v. shfrytëzimi i pronësisë intelektuale të Universitetit;
- vi. shfrytëzimi i objekteve të Universitetit për konferenca, seminare, mbledhje dhe raste të ngjashme;
- vii. kontratat për shërbime akademike dhe jo-akademike;
- viii. çdo lloj tjetër burimi i lejuar me ligj.

Neni 82

82.1 Bordi i Universitetit do të themelojë Komitetin për Auditim dhe Menaxhim të Rrezikut

82.2 Komiteti për Auditim dhe Menaxhim të Rrezikut do ti rekomandojë Bordit të Universitetit caktimin e revizorëve të pavarur të jashtëm për të bërë revizionin vjetor lidhur me shfrytëzimin e drejtë të burimeve dhe mënjanimit të falsifikimeve, dhe pas revizionit të jap çertifikatë. Revizorët gjithashtu do të raportojnë, nëse kjo kërkohet nga Bordi i Universitetit ose Komitetit për Auditim dhe Menaxhim të Rrezikut, lidhur me mjaftueshmërinë e masave të kontrollit financiar në Universitet, shfrytëzimin e burimeve me kosto efektive, pagueshmërinë e të dhënave apo studime të posaçme të fakulteteve, njësi organizative apo shërbimi administrativ.

82.3 Revizorët e emëruar sipas paragrafit të mësipërm nuk duhet të kenë marrëdhënie direkte personale ose profesionale me asnjërin prej anëtarëve të Bordit të Universitetit ose Senatit.

84.4 Bordi gjithashtu mund të caktojë edhe një revizor të brendshëm si pjesë e shërbimit profesional, me detyrime të përcaktuara nga Sekretari i Përgjithshëm, pas konsultimeve me kryetarin e Bordit të Universitetit.

84.5 Edhe revizori i pavarur i jashtëm edhe ai i brendshëm, kanë të drejtën e mbajtjes së kontakteve të drejtpërdrejta me Kryetarin e Bordit.

Pjesa XV: Dokumentacioni

Neni 83

Sekretari i përgjithshëm i Universitetit është përgjegjës për mbajtjen e shënimeve të sakta për:

1. kandidatët e paraqitur për pranim;
2. studentët e regjistruar në të gjitha programet studimore dhe kërkimore;
3. të diplomuarit;
4. stafit të punësuar me kontrata;
5. pronës së universitetit;
6. llogarive financiare;
7. projekteve hulumtuese;
8. kontratave për hulumtim dhe këshillim;
9. kontratave komerciale; dhe
10. çështjeve tjera siç kërkohen nga Bordi i Universitetit.

Neni 84

I gjithë stafi dhe studentët e Universitetit duhet të bashkëpunojnë me Sekretarin e përgjithshëm të Universitetit sa i takon dhënies së informatave që duhen ruajtur sipas evidencës nga neni paraprak.

Neni 85

Të gjitha të dhënat personale do të trajtohen me respekt ndaj privatësisë së tyre dhe të hapen vetëm për qëllime të caktuara me ligj ose me këtë Statut.

Pjesa XVI: Organizimi i të punësuarve dhe studentëve

Neni 86

Stafi ka të drejtë grupimi paqësor dhe të drejtën të formojë sindikata apo shoqata të stafit për t'i prezantuar interesat e tyre kolektive te autoritetet e Universitetit dhe për qëllime tjera brenda ligjit.

Neni 87

Do të ketë edhe një organizatë studentore në të cilën mund të marrin pjesë të gjithë studentët.

Neni 88

88.1 Organizata studentore ka Statutin e saj të miratuar nga anëtarët e saj dhe nga Bordi i Universitetit. Statuti do të përfaqësojë parimet e mundësive të barabarta dhe mos-diskriminimit.

88.2 Ndryshimet në Statutin e organizatës studentore do të jenë lëndë miratimi e Bordit të Universitetit me propozim të Rektoratit.

Neni 89

Kuvendi i anëtarëve do të jetë trupi suprem për vendimmarrje i organizatës studentore.

Neni 90

Organizata studentore e themeluar në pajtueshmëri me këtë pjesë, do të zgjedhë, në mënyrë të drejtë dhe të lirë, përfaqësues në trupat e përcaktuar me këtë Statut, që do të veprojnë në emër të saj në raport me autoritetet e Universitetit.

Neni 91

Studentët kanë të drejtën e grupimit (tubimeve) paqësor(e).

Neni 92

Studentët gjithashtu kanë të drejtë të formojnë shoqata për qëllime të ndryshme të lejuara me ligj.

Neni 93

Allumnit (te diplomuarit) e Universitetit mund të formojnë Asociacionin e Alumnive dhe të definojnë organizimin dhe funksionimin me Statut i cili do aprovohet nga Bordi i Universitetit.

Pjesa XVII: Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare

Neni 94

94.1 Personat që mbajnë vendet e punës në datën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti do të vazhdojnë me punën e tyre sipas kushteve dhe rrethanave të kontratës deri në datën e emërimeve të reja në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

94.2 Anëtarët e Bordit të Universitetit në post më 1 dhjetor 2008 do të vazhdojnë në të njëjtat poste deri më fund të mandatit të tyre katër vjeçar deri më 31 gusht 2012.

94.3 Qendrat, institutet dhe njësitë e ngjashme që ekzistojnë deri më 30 nëntor 2008, do të rreshtohen brenda strukturës së përmendur në Pjesën VIII të këtij Statuti deri më 30 Nëntor 2009.

Neni 95

Çdo aktivitet ekzistues në Universitet, pavarësisht origjinës së saj ligjore ose vlefshmërisë, e që nuk është në kundërshtim me këtë Statut, do të vazhdojë me fuqi të plotë dhe efekt derisa Bordi i Universitetit të vendosë ndryshe.

Neni 96

Bordi i Universitetit është përgjegjësi i vetëm për interpretimin e këtij Statuti dhe zgjidhjen e çfarëdo konflikti.

Neni 97

Propozimet për ndryshimet e Statutit të bëra nga Senati, Këshilli i Rektorit apo Rektori kërkojnë miratimin nga ana e Bordit të Universitetit në bazë të procedurës speciale të specifikuar në nenin 14.2.

Neni 98

Studentët ekzistues do të mbeten në programet në të cilat fillimisht janë regjistruar sipas rregullave akademike dhe të tjera të përpiluara ose të autorizuara të vazhdojnë me këtë Statut.

Neni 99

Rektori do t'i raportojë rregullisht Këshillit të Rektorit, Senatit, Bordit të Universitetit dhe Komitetit Ekzekutiv, sipas nevojës, lidhur me implementimin e dispozitave të këtij Statuti.

Neni 100

100.1 Ky Statut hyn në fuqi më 1 dhjetor 2008.

100.2 Statuti ekzistues i Universitetit të Evropës Juglindore (valid deri më 30 nëntor 2008) shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij Statuti.